

Ekskluzive/Intervistë e Ambasadorit Pavel Vacek

Vacek: Të gjendet mirëkuptimi për zgjedhjet

By Erind Maçi

Ditët e fundit janë zhvilluar bisedime për amendimin e Kodit Zgjedhor. Më konkretisht, opozita ka propozuar ndryshimin e ligjit për të njehsuar votën për partinë me votën për kandidatin. Kjo është një përpjekje për të shmangur mundësinë që një ose të dy partitë e mëdha të maksimizojë votat që mund të marrin duke i udhëzuar simpatizantët të votojnë për kandidatin e tyre në votimin për kandidatë dhe për një nga partitë e vogla aleate në votimin për parti. A mendon OSBE-ja që kjo çështje ka nevojë të shqyrtohet përpara zgjedhjeve?

“Sistemi aktual zgjedhor në Shqipëri jep mundësinë që rezultati i zgjedhjeve të shtrembërohet me anë të përdorimit të votimit taktik, siç përshkruhet në pyetje. Dispozitat e Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor nuk i ndalojnë në mënyrë eksplicite praktika të tilla, por kjo nuk i bën ato të pranueshme, e jo më pastaj të dëshirueshme. Gjithashtu, u takon organeve kushtetuese shqiptare të veprojnë në mënyrë të përshtatshme për të përcaktuar përputhshmërinë e praktikave të tilla me Kushtetutën dhe legjislacionin zgjedhor. Në fund të fundit, do të jetë në dorë të zgjedhësve shqiptarë të gjykojnë nëse dhe si këto marrëveshje që po planifikohen do të shtrembërojnë vullnetin e tyre, e më pas të vendosin”.

A është, siç thonë disa, tepër vonë për të amenduar Kodin Zgjedhor lidhur me këtë çështje?

“Çdo përpjekje për të amenduar Kodin Zgjedhor të miratuar kohët e fundit – dhe për më tepër shumë pranë zgjedhjeve – është problematike, veçanërisht nëse nuk bëhet fjalë thjesht për një ndryshim teknik... megjithatë, nuk është tabu. Ne pamë miratimin e një ndryshimi që shfuqizonte dispozitën e Kodit Zgjedhor, e cila e bënte Kodin të pavlefshëm ditën pas zgjedhjeve të 2005-ës. Sigurisht, një konsensus i gjerë do të nevojitej për një ndryshim të tillë të Kodit Zgjedhor, i cili do të ndalonte ose rregullonte marrëveshjet për ndarjen e votave”.

Këto lloj manovrimesh konsiderohen të ligjshme në ligjin aktual. A dini ndonjë vend tjetër ku kjo gjë zbatohet në atë shkallë sa pritet të zbatohet gjatë zgjedhjeve të ardhshme këtu në Shqipëri dhe a ka çuar kjo në zgjedhje të kundërshtuara gjatë?

“Gjithmonë ka pasur marrëveshje dhe ujdi lokale e informale mes kandidatëve individualë, madje edhe mes partive, në një nivel shumë lokal në të gjitha zgjedhjet që janë zhvilluar në çdo vend të botës. Masa deri në të cilën kjo ndodh varet nga ligji dhe tradita lokale në secilin vend ose sistem zgjedhor. Kjo është arsyeja që thuajse nuk ka ndonjë standard ndërkombëtar të pranuar lidhur me praktika të tilla. Unë nuk di ndonjë vend evropian, ku sistemi zgjedhor të jetë identik me atë në Shqipëri – prandaj krahasimet do të ishin çorientuese. Ndikimi i marrëveshjeve të tilla për ndarjen e

voteve është gjithmonë i lidhur me sistemin zgjedhor... dhe përgjithësisht mendohet që ndikimi i tyre brenda sistemit shqiptar është shtrembërues”.

Të gjithë pajtohen me mendimin se Shqipëria duhet të zhvillojë zgjedhje të lira, të ndershme dhe të pakundërshtueshme. Nëse një ose më shumë parti ankohen për rezultatin e zgjedhjeve pikërisht sepse kundërshtarët e tyre përfituan në shkallë të madhe nga ndarja e votave për partinë me aleatët e tyre, a do ta quante OSBE-ja këtë një argument të vlefshëm?

“Natyrisht, OSBE-ja punon për zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë hapësirën e saj të veprimit. ODIHR-i dhe veprimet e tij monitoruese nuk janë arbitrat përfundimtarë dhe as ata që sigurojnë ndershmërinë në zgjedhje. Në fund të fundit, u takon vetë organeve kushtetuese shqiptare – Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe gjykatave shqiptare – të merren me shkeljet, si dhe me kundërshtimet”.

Në ç’përqindje është e gatshme OSBE-ja ta tolerojë këtë dukuri? Nëse një nga partitë e mëdha fiton 50 kandidatë në raundin e parë, por del që ka marrë vetëm 20% të votave në shkallë kombëtare sepse votat e tjera i ka shpërndarë mes aleatëve të saj në mënyrë që ata të kenë kandidatë nga lista proporcionale, a shikohet kjo si teprim? Nëse po, ku është kufiri për ju?

“Ky është thjesht spekulim dhe, për më tepër, ne nuk i qasemi problemit duke përcaktuar me terma numerikë se çfarë është e pranueshme dhe çfarë jo. Ajo që mund të dëgjoni prej nesh është: praktika të tilla shtrembërojnë sistemin dhe është në dorë të shqiptarëve të merren me këtë – qoftë me ndihmën e Organizatës, nëse duan, ose pa të”.

Në zgjedhjet e shkuara ka pasur mospërputhje mes votave për kandidatin dhe votave për partinë. Disa njerëz pëlqyen më shumë kandidatin se sa partinë që ai/ajo përfaqësonte dhe e anasjellta. Të dhënat tonat tregojnë se me përjashtim të zonës zgjedhore të Dushkut gjatë zgjedhjeve të vitit 2001, kjo ka qenë një dukuri e kufizuar, që nuk e kalonte 2-5% të totalit të votave. A do të përdorë bashkësia ndërkombëtare standarde më të buta këtë herë?

“Është mëse e drejtë që votuesi të zgjedhë çfarëdo kombinim të kandidatëve dhe partive, për sa kohë që fletët e votimit plotësohen në mënyrë teknikisht të vlefshme. Është e drejta ekskluzive e zgjedhësit dhe, gjithashtu, përgjegjësia e tij për të bërë zgjedhjen. Por është përgjegjësia e përbashkët e shumë aktorëve të tjerë, kryesisht e partive politike dhe e kandidatëve, si dhe e të gjithë klasës politike dhe institucioneve, të sigurojnë që votuesi e ka bërë zgjedhjen e tij duke qenë i mirëinformuar dhe i bazuar vetëm në vullnetin e tij të lirë. Kjo na kthen sërish në thelbin e çështjes: askush s’mund t’i zgjidhë këto probleme në vend të shqiptarëve... Institucionet ndërkombëtare ndihmojnë, por rrallë imponojnë... Veç kësaj, nuk mendoj se standardet zgjedhore ndërkombëtare ose zbatimi i tyre po zbutet me kalimin e kohës, qoftë në Shqipëri apo gjetkë... Përkundrazi”.

Tirana u vizitua nga Kryetari i OSBE-së para disa ditësh dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri sponsorizoi një dialog për çështjen e datës së zgjedhjeve. Do të ishit të gatshëm të sponsorizonit një dialog edhe për çështjen e ndarjes së votave për partinë mes aleatëve politikë?

“Prezenca e OSBE-së mund të sponsorizojë shumë gjëra – për sa kohë që ato janë në mandatin tonë dhe ne na kërkohet ta bëjmë këtë, por në këtë rast nuk ka nevojë për sponsor. Çka nevojitet është vullneti i partive politike për të pranuar që ka një problem dhe për të bërë të pamundurën për ta parandaluar atë. U takon Kuvendit dhe organeve të tjera kushtetuese, medias dhe shoqërisë civile, si dhe kujtdo që ndihet i shqetësuar në një vend të lirë të merren me këtë problem”.